



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 gusht 2016
Ref. no.:RK 975/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI06/15

Parashtrues

Sadik Abazi

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Pml. Kzz 98/2014, të 3 shtatorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesën e dorëzoi z. Sadik Abazi nga fshati Davidoc, komuna e Shtimes (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson z. Naim Qelaj, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. Kzz. 98/2014, të 3 shtatorit 2014, i cili i është dorëzuar më 26 tetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimin të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht pezullimin e zbatimit të vendimit për vuajtjen e dënimit deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë vendimin për kërkesën.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29, 55 dhe 56 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 27 mars 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin, Gjykatën Supreme dhe Zyrën e Prokurorisë Speciale (në tekstin e mëtejme: PS) për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 14 maj 2014, PS i dorëzoi komentet e veta lidhur me kërkesën.
10. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit i kishte përfunduar mandati.
11. Gjithashtu, të njëjtën ditë, Kryetarja nxori vendimin me të cilin gjyqtari Robert Carolan, i cili u caktua gjyqtar raportues, zëvendësohet në Kolegjin shqyrtues nga gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi.
12. Më 11 korrik 2016, Kryetarja e zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan si gjyqtar raportues me gjyqtaren Snezhana Botusharova.

13. Më 14 korrik 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për deklarimin e kërkesës si të papranueshme dhe për refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 29 korrik 2011, PS ngriti aktakuzë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë [PPS. nr. 460/09], kundër parashtruesit të kërkesës me pretendimin se ka kryer disa vepra penale.
15. Më 17 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi P. nr. 592/11] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale vrasje të rëndë.
16. Më 28 mars 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Kodit Penal dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
17. PS brenda afatit ligjor paraqiti përgjigje ndaj pretendimeve nga ankesa e parashtruesit të kërkesës, *“se Aktgjykimi i kundërshtuar është plotësisht i kuptueshëm, i qartë dhe i saktë”*.
18. Më 12 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit [Aktgjykimi PARK 102/13] e vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke e shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor për vrasje të rëndë.
19. Më 30 prill 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar shkelje të dispozitave përkatëse të Ligjit për procedurën penale dhe shkelje të Ligjit penal.
20. PS dorëzoi përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke theksuar se *“kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike”* dhe se *“argumentet janë identike me ato të ngritura në ankesën kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Ato tashmë janë adresuar dhe refuzuar nga Gjykata e Apelit”*.
21. Më 3 shtator 2014, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Pml. Kzz 98/2014] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, sepse nuk ka mundur të *“identifikojë ndonjë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit në asnjërin aktgjykim”* dhe *“nuk ka pasur shkelje të dispozitave të Ligjit penal”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës dhe me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

23. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin *in dubio pro reo*. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë bazuar konstatimin e tyre për fajësinë ekskluzivisht në dëshminë e një dëshmitari bashkëpunues, ndërsa vërtetësia e kësaj dëshmie nuk është provuar mjaftueshëm, si dhe dëshmia e dëshmitarëve tjerë është gjetur si e rreme. Për më tepër, gjykatat e rregullta e refuzuan kërkesën e parashtruesit për kryerje të vlerësimit psikologjik të dëshmitarit bashkëpunues.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta po ashtu nuk morën parasysh dëshminë e alibisë të propozuar nga parashtruesi. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat penale është dashur t'i japin parashtruesit përparësinë e dyshimeve të ngritura nga mungesa e besueshmërisë së provave dhe jo ta shpallin atë fajtor. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se gjykatat e rregullta ishin politikisht të njëanshme ndaj tij duke shkelur të drejtën e barazisë para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ia mohoi të drejtën për dëgjim publik kur vendosi të refuzojë kërkesën e tij për paraqitje të provave të reja në seancë publike. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo përbën shkelje të së drejtës për mjet juridik, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës.
26. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:
- Të shpallë kërkesën të pranueshme,*
 - Të konstatojë se Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin P.nr.592/11 të datës 17.12.2012, Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.102/13 të datës 12.12.2013 dhe Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Pml.Kzz.98/14 të datës 03.09.2014 kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit, pasi që veprimet e gjykatave janë të përfshira me shkelje të nenit 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm) të Kushtetutës dhe nenit 6 (e drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 24 (barazia para ligjit) të Kushtetutës, neni 32 (e drejta për mjet juridik) të Kushtetutës dhe nenin 33 (parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale) të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,*
 - Të shpallë të pavlefshme (të anulojë) Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.592/11 të datës 17.12.2012, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me PAKR.nr.102/13 të datës 12.12.2013 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.Kzz.98/14 të datës 03.09.2014.*
 - Bazuar në nenin 52 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, suspendohen të gjitha veprimet para gjykatave të faktit -referuese, deri në nxjerrjen e vendimeve të Gjykatës.*

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata, po ashtu, rikujton nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

30. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

31. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit kryesisht kanë të bëjnë me mënyrën se si janë trajtuar provat e paraqitura nga dëshmitari bashkëpunues, N.B. Parashtruesi i kërkesës konsideron se dëshmitari bashkëpunues nuk ishte

i besueshëm dhe se nuk kishte prova tjera të mjaftueshme për ta vërtetuar këtë dëshmi. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat nuk kanë ekzaminuar në mënyrë adekuate besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues me rastin e nxjerrjes së aktgjykimeve të tyre, si dhe nuk i morën parasysh argumentet e tij lidhur me këtë besueshmëri.

32. Gjykata rikujton nenin 31 të Kushtetutës, i cili *inter alia* përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

[...]”

33. Gjykata, po ashtu, rikujton nenin 6 të KEDNJ-së, ku *inter alia* thuhet:

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

[...]

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

[...]

d) të pyes, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

[...]

34. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, që ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë, në thelb merren me faktin nëse parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të mjaftueshme që ta parashtrojë rastin e tij dhe të kontestojë provat që ai i konsideronte të rreme. Për më tepër, nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve nga gjykatat e rregullta me një vlerësim të vet dhe, si rregull i përgjithshëm, u takon këtyre gjykatave të bëjnë vlerësimin e provave që u paraqitën atyre. Detyrë e Gjykatës është të konstatojë nëse procedurat në tërësinë e tyre, përfshirë mënyrën e marrjes së provave, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, paragrafi 34).
35. Gjykata nuk mund të zëvendësojë gjykimin e Gjykatës së Qarkut në lidhje me atë se çfarë dëshmuar apo nuk dëshmuar provat në rastin e parashtruesit të kërkesës. Për të gjetur se ka pasur shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë në këtë rast, në lidhje me mjaftueshmërinë e provave, kjo Gjykatë do të duhej të gjejë se jo vetëm arsyetimi i Gjykatës së Qarkut, por edhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit, si dhe ai i Gjykatës Supreme në lidhje me mbështetjen e dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunues, kishin aq të meta sa që nuk kishin asnjë mbështetje dhe se aktgjykimet e tyre nuk ishin të arsyetuara.
36. Gjykata rikujton se nëse aktgjykimi për dënim nuk është i arsyetuar, ekziston supozimi se i pandehuri nuk ka pasur gjykim të drejtë. Gjykata, gjithashtu, vëren se aktgjykimi për dënim nuk mund të bazohet vetëm në dëshminë e pambështetur të dëshmitarit bashkëpunues (Shih *mutatis mutandis* Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese i 2 qershorit 2016, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. Pml Kzz. 157/2014, të 2 tetorit 2014*, paragrafi 39).
37. Gjykata konsideron se për të konstatuar se parashtruesi nuk ka pasur një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës ose të nenit 6 të KEDNJ-së, kjo Gjykatë do të duhej të konstatojë se vendimi për dënim dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishin të arsyetuara. Përveç kësaj, Gjykata do të duhet të konstatojë se dëshmitë e dëshmitarit bashkëpunues nuk ishin mbështetur sa duhet në mënyrë që ajo të jetë mjaft e besueshme për të mbështetur përtej dyshimit të arsyeshëm vendimin dhe aktgjykimin fajësues.
38. Kjo Gjykatë nuk mund ta bëjë këtë konstatim në këtë rast. Në të vërtetë, Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë dhënë konstatime të detajuara faktike në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe provave shtesë mbështetëse në favor të vendimit me të cilin ishte provuar se parashtruesi është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullsisë civile.
39. Prandaj, Gjykata konkludon se ky pretendim për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë duhet të refuzohet si i papranueshëm.
40. Sa i përket dështimit të pretenduar të Gjykatës së Apelit për të urdhëruar vlerësim psikologjik të dëshmitarit bashkëpunues, refuzimit nga gjykatat e

rregullta të mbrojtjes së parashtruesit me alibi, pretendimit se gjykimi ishte politik dhe se parashtruesit iu mohua dëgjimi pranë Gjykatës së Apelit, parashtruesi nuk ka arritur të dëshmojë pretendimin e tij lidhur me atë se si cilado nga këto shkelje të pretenduara, në qoftë se ato kanë ndodhur, ka rezultuar me shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë. Prandaj, këto pretendime gjithashtu, duhet të refuzohen si të papranueshme.

41. Gjykata thekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e nxjerra nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
42. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka gjetur se procedurat përkatëse pranë gjykatave të rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
43. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin e tij mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, me vendimin e kontestuar.
44. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme

45. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkoi nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme “*përkatësisht, suspendimin e zbatimit të vendimit për vuajtjen e dënimit deri sa Gjykata Kushtetuese të merr vendim për kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme*”.
46. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masën e përkohshme në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5), të Rregullores së punës, duhet së pari të përcaktojë:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin *prima facie* për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

[...]

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

47. Siç u theksua më lart, parashtruesi nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme do të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 27 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) dhe (2) b) dhe d), dhe në mbështetje të rregullit 64 të Rregullores së punës, më 14 korrik 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T’ UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi